



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 208/5 prot.

Datë 30.03.2022

V E N D I M

Nr. 294/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.03.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-14628-12-09-2021, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol*” Sh.A, me fond limit 84,175,068 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.01.2022, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).

Ankimues:

BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK
Fshati Balëz pranë Fabrikës së Cimentos Elbasan

Autoriteti Kontraktor:

ALBCONTROL SHA
Aeroporti “NENE TEREZA”, Rinas.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave*”

për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.12.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” Sh.A, me fond limit 84,175,068 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.01.2022, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).

II.2. Në datën 19.01.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.01.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- Alpen Pulito	58,680,000	I skualifikuar
- Alko Impex General Contruction	59,844,210	I skualifikuar

- Clean Fast	70,999,992	I skualifikuar
- Dion Al	74,952,650	I skualifikuar
- Albstone	79,170,408	I skualifikuar
- Pastrime Silvio	82,465,056	I skualifikuar

II.4. Në datën 31.01.2022 BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme:*
 - *a) Vlerësimi e ndikimi ne mjedis dhe auditim mjedisor.*
 - *b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane.*
 - *c) Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shendetesore (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim).*
- *Sipas kontrates se bashkepunimit per bashkimin e operatoreve ekonomike, me nr. 312 Rep dhe nr. 214 Kol. datë 18.01.2022, pjesëmarrja në këtë procedure është ndarë në raportet: 43.3 % për operatorin ekonomik “Albstone” ShPK dhe 56.7 % për operatorin ekonomik “Sori-AL” ShPK.*
- *Në bazë të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Nenit 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 e tij specifikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur ne SPE rezulton se operatori ekonomik “Albstone” ShPK, pjese e ketij bashkimi, nuk ka përmbushur pikën 2.3.4 në raport me përqindjen e marre persiper sipas kontrates se bashkepunimit.*

II.5. Në datën 01.02.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-Anulimit** në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.02.2022, BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK, ka paraqitur ankesë në sistemin e ankesave elektronike me numër ankimi elektronik A/2022/1832 pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

- *Në rastin konkret, konform Nenit 41 pika 4a, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; të cilën Autoriteti Kontraktor e ka kërkuar*

në pikën 2.3.4 të DST si më poshtë:

- *Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtëm:*
- *Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor. (Kategoria C).*
- *Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane (KategoriaC).*
- *Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shëndetësore (Dezinfektim,Dezinsektim, Deratizim). ”*
- *Në konform me Nenin 88 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Shoqëria Albstone ShPK duke qene në pamundësi të përmbushjes së pikës 2.3.4 të DST ka kërkuar asistencën në dokumentacion dhe licenca nga Shoqëria SORI-AL ku dhe kanë kryer një marrëveshje bashkëpunimi, nga ku SORI-AL ka përmbushur kërkesat e pikave 2.3.4 sipas dokumentacionin të dorëzuar ku specifikisht Operatori Sori-Al ShPK ka vendosur licencat/lejet e mëposhtme:*
- *Licencën me Kodi III.2.A. (1+2) me Nr. LN-6095-01 me Emërtim: Vlerësim i ndikimit nëmjedis dhe auditim mjedisor”;*
- *Licencën me Kodi III.2.B me Nr. LN-6254-03-2013 me Emërtim: Grumbullim, transportim,ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve urbane”;*
- *Licencën me Kodi II.8.B me Nr. LN-4565-02-2012 me Emërtim Dezinfektim, deratizim,dezinsektim”.*
- *Pra duke vendosur këtë dokumentacion Sori Al ShPK si pjesëmarrës në BOE me 56.7 % ka arritur të përmbushë kërkesat e Nenit 88 pika 3 sepse tashmë i gjithë operatori ekonomik ka përmbushur Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhettë përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje”. Ligji është absolutisht i qartë kur ka kërkuar që i gjithë BOE dhe jo çdo operator duhet të përmbushë këto kritere të cilat BOE Albstone ShPK dhe Sori-AL ShPK i ka përmbushur.*
- *Sipas Kontratës së Bashkëpunimit Nr.312 Rep dhe Nr.214 Kol të nënshkruar më 18/01/2022, arsyeja përse Operatori Ekonomik Albstone ShPK ka marrë 43.3% është sepse ka ofruar personat e saj të stafit që të punojnë dhe të asistojnë shoqërinë Sori-AL si lider në këtë Bashkim Operatorësh dhe gjithashtu ka ofruar makineri dhe kamionin me kosh sipas kontratës noteriale të qirasë me Nr. 238 Rep dhe Nr. 164 Kol nënshkruar më 14/01/2022 midis Albstone ShPK dhe Gurali Stafaj person fizik me Nr. Nipt L81316021R. Pra për këtë arsye sipas llogaritjeve ekonomike, dhe profesionale Shoqëria ALbstone ShPK i takonte 43.3%, ndërsa pjesa tjetër i takon shoqërisë Sori-AL ShPK.*
- *Pra konform kërkesave të Nenit 88 VKM Nr.285 Datë 19.05.2021, Bashkimi i Operatorëve ka përmbushur pikën 2.3.4 në tërësi si dhe kërkohet nga ligji sepse Operatori Sori-Al ka dorëzuarlicencat e mësipërme konfrom kërkesave të DST-ve.*
- *Sa më sipër kërkojmë pranimin dhe kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE ALBSTONESHPK & SORI-AL ShPK.*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularët e publikimit nr.208/3 prot datë 04.02.2022 me arsyet e skualifikimit të BOE ankimues.

II.7. Me shkresën nr. 393/1 prot, datë 08.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 208/4 prot datë 10.02.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE “ALBSTONE SHPK & SORI-AL SHPK, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1.Lidhur me pretendimet e BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “*Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme:*

- a) *Vlerësimi e ndikimi ne mjedis dhe auditim mjedisor.*
- b) *Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane.*
- c) *Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shendetesore (Dezinsektim, Dezinsektim, Deratizim).*
- *Sipas kontrates se bashkepunimit per bashkimin e operatoreve ekonomik, me nr. 312 Rep dhe nr. 214 Kol. datë 18.01.2022, pjesëmarrja në këtë procedure është ndarë në raportet: 43.3 % për operatorin ekonomik “Albstone” ShPK dhe 56.7 % për operatorin ekonomik “Sori-Al” ShPK.*
- *Në bazë të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Nenit 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 e tij specifikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur ne SPE rezulton se*

operatori ekonomik “Albstone” ShPK, pjese e ketij bashkimi, nuk ka përmbushur pikën 2.3.4 në raport me përqindjen e marre persiper sipas kontrates se bashkepunimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Pika 2.3.4. për kapacitetin teknik ishte:

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtëm:

- a) Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor. (Kategoria C).*
- b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane. (Kategoria C).*
- c) Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për pastrimin e sistemit, gjelbërimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucioneve (Leje C).*
- d) Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shëndetësore (Dezinsektim, Deratizim).*

Pika 2.3.4. për kapacitetin teknik bëhet:

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtëm:

- a) Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor. (Kategoria C).*
- b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane (Kategoria C).*
- c) Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shëndetësore (Dezinsektim, Deratizim).*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Bashkëpunimi Nr.312 Rep Nr.214 Kol datë 18.01.2022 lidhur ndërmjet Shoqëria Albstone SHPK dhe Sori Al ShPK për realizmin e objektit *Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” Sh.A. Në nenin 4 Pjesëmarrja parashikohet se: Palët deklarojnë se kapacitetet dhe burimet që secila prej tyre angazhon në këtë marrëveshje në natyrë ose përmes kontributit financiar do të jenë të llojit si më poshtë:*

■ *Albstone Makinieri dhe Pajisje; Burime Njerzore*

■ *Sori Al Eksperiencë dhe know-how; Pajisje; Burimet e zinxhirit të furnizimit me pajisje dhe detergjente*

Bazuar në këtë kontratë të lidhur mes palëve 43.3 % e kapacitetit teknik dhe financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria Albstone dhe 56.7 % e

kapacitetit teknik dhe financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria Sori Al ShPK.

- *Preventivi i ndarjes së zërave të shërbimit*
- *Leje Mjedisi Tipi C me Kod III.1.A Albstone ShPK*
- *Licencë Kodi III.2.A Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor Sori Al ShPK*
- *Licencë Kodi III.2.B Grumbullim transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetje urbane Sori Al ShPK*
- *Licencë Kodi II.8.B Dezinsektim, Deratizim, Dezinsektim Sori Al ShPK*

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

III.1.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- *a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- *b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 41*
- *c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- *ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
- 2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

III.1.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, në rastin kur oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. Ndërkohë autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë disponimin e **Licencave/Lejeve** si a) Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor. (Kategoria C). b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane (Kategoria C) dhe c) Licence II.8.B, Licence për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-shëndetësore (Dezinfektim, Dezinfektim, Deratizim). BOE ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar kontratë bashkëpunimi Nr.312 Rep Nr.214 Kol datë 18.01.2022 lidhur mes palëve ; Leje Mjedis Tipi C me Kod III.1.A Albstone ShPK; Licencë Kodi III.2.A Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor Sori Al ShPK; Licencë Kodi III.2.B Grumbullim transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetje urbane Sori Al ShPK; Licencë Kodi II.8.B

Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim Sori Al ShPK. KPP vëren, se anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë kanë përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit përqindjen përkatëse që kanë marrë përsipër të realizojnë, si dhe natyrën e kontributit nga secili prej tyre. Konkretisht në kontratën e bashkëpunimit përcaktohet, se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve Albstone SHPK do të realizojë 43.3 % të zërave të shërbimit, ndërsa do të kontribuojë në burime njerëzore makineri dhe pajisje. Gjithashtu, palët kanë dorëzuar edhe preventivin e punimeve, në të cilin pasqyrohen zërat konkretë që do të realizojë secili prej anëtarëve si dhe përqindjet përkatëse. KPP vëren, se në preventivin e paraqitur për zërin Monitorim e shërbime DDD, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Albstone” ShPK, nuk do të marrë pjesë në realizimin e këtij shërbimi. KPP gjykon, se qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të mund të zotërojë kapacitete **ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.** Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes, bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues, KPP gjykon, se anëtari i bashkimit Albstone SHPK, nuk ka marrë përsipër realizimin e ndonjë zëri të vecantë të preventivit, i cili kërkon licensimin me licencat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit. Anëtari tjetër i bashkimit Sori Al ShPK me dokumentacionin e paraqitur dëshmon, se plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se anëtarët e bashkimit kanë plotësuar kriterin e kualifikimit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit dhe në përputhje me natyrën e zërave të shërbimit, që do të kryejnë në funksion të realizimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues “Albstone” SHPK & “Sori-AL” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Albstone” SHPK & “Sori-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” Sh.A, me

fond limit 84,175,068 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.01.2022, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL Sh.A (ish A.N.T.A).

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Albstone” SHPK& “Sori-AL” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

